

**Plotësimi i Rregullës së IX mbi
Klasifikimin e mjeteve, Rezervën për humbje nga huatë, Trajtimi i interesit të
përlllogaritur dhe Trajtimi i riprogramimit të ekspozimeve kreditore
Autorizuar sipas Nenit 27 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/21**

1. Përmbledhje

Kjo rregull zëvendëson rregullën bankare Nr. IX të AQBK-së e cila është miratuar nga Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës me 17 Shkurt, 2000. Kjo rregull ofron standarde të korigjuara të AQBK-së për klasifikimin dhe provizionimin nga ana e bankave si dhe kërkesat për trajtimin e interesit të përlllogaritur dhe riprogramimit të borxhit.

2. Fushëveprimi

Kjo Rregull është e zbatueshme për të gjitha bankat, filialat e bankave të huaja, dhe institucionet mikro financiare në Kosovë.

3. Kategoritë e klasifikimit

Bankat duhet të shqyrtojnë dhe të klasifikojnë ekspozimet e rrezikut kreditor më së paku në baza tre mujore. Bankat mund të shqyrtojnë dhe të klasifikojnë më shpeshë portfoliotë e tyre. Bankat duhet të përpilojnë politikat dhe procedurat që të drejtojnë procesin e shqyrtimit dhe klasifikimit, si dhe mbikqyrësit e AQBK-së gjatë ekzaminimit të brendshëm do të shqyrtojnë përshtatshmërinë e këtyre politikave dhe procedurave.

Udhëzimi në vijim ofrohet në lidhje me klasifikimet e ekspozimeve kreditore ¹:

Standarde. Të gjitha kreditë apo shërbimet tjera të drejtpërdrejta kreditore dhe ekspozimet jashtë bilancore që bartin një rrezik normal bankar. Informacionet në dispozicion në lidhje me ekspozimet kreditore, performansën e llogarisë së klientit, dhe të dhënat financiare që të gjitha këto dëshmojnë se shlyerja e ekspozimit është mjaft e sigurtë dhe nuk ka ndonjë vështirësi (apo obligimi është i siguruar plotësisht me kolateral të përshtatshëm). Kredia është aktive, apo delikuenca nuk është vonuar më shumë se tri dhjetë – 30 ditë nga data e kthimit apo maturimit të kredisë. Mbitërheqjet duhet të jenë brenda limitit të caktuar, ose vetëm përkohësisht të tejkalojnë limitin prej 5% ose më pak se 30 ditë, si dhe rrjedha e parasë në llogarinë rrjedhëse është e mjaftueshme për të shlyer bilancin e mbitërheqjes brenda 30 ditëve nga data e skadimit të mbitërheqjes.

Vëmendje të posaçme (ose Vrojtuese). Ky klasifikim duhet të përdoret për të identifikuar dhe monitoruar ekspozimet që përmbajnë dobësi apo dobësi potenciale të

¹ Për qëllime të udhëzimeve të klasifikimit, termi “ llogaria e mbitërheqjes” ka të bëjë me ato mbitërheqje të para aprovuara, linjat kreditore, si dhe mbitërheqjet tjera kreditore. Mbitërheqjet e rastësishme janë të cekura në Paragrafin 13.

cilat në rastin e rishqyrtimit, nuk e rrezikojnë kthimin e kredisë apo nuk reflektojnë ndonjë potencial për ndonjë humbje, por të cilat, po qe se nuk adresohen apo nuk korrigjohen mund të rezultojnë në keqësimin e kredisë në nën standard apo klasifikim më të ashpër. Në rast se ka mungesë të ndonjë dëshmie të dokumentuar që është e pafavorshme, apo këto kredi vonohen më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë atëherë bankat duhet t'i klasifikojnë këto kredi si "Kredi me vëmendje të posaqme", si dhe ato kredi që janë vazhdimisht në mbetje të borxhit në tejkalim të 5% të linjave të aprovuara për më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë .Kjo kategori e klasifikimit është përpiluar që t'ju mundësojë bankave që të identifikojnë dhe adresojnë marrëdhëniet shumë të dobëta që në fazën e hershme. Ky klasifikim mund të përdoret gjithashtu për kreditë apo grupet e kredive të cilat janë të strukturuar dobët si rezultat i analizave të pamjaftueshme apo njohurive teknike nga ana e nëpunësve kreditorë. Kjo kategori nuk mund të përdoret për ekspozimet që kanë dobësi në dokumentacion dhe të cilat nuk ndikojnë në ri-pagimin potencial të kredisë. Këto duhet të radhiten si përjashtime teknike dhe të mos kritikohen.

Nën Standard. Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, janë definuar qartë dobësitë e kredisë të cilat rrezikojnë pagesën e kredisë në një kurs normal. Një kredi Nën Standard është ajo kredi e cila në bazë të analizave të të dhënave financiare si dhe faktorëve të tjerë, nuk është e mbrojtur për momentin nga vlera e shëndoshë si dhe nga kapaciteti i pagesës së huamarrësit apo garantuesit ose vlera e kolateralit. Kërkohe mbështetje nga ana e garantuesve përgjegjës dhe të aftë për të kthyer kredinë gjë që do të përfshinte edhe negociata të vazhdueshme para se likuidimi i kredisë të kërkojë një klasifikim Nën standard. Nevoja për të kërkuar mbështetjen e kolateralit si mjet për të shlyer obligimin duhet të jetë bazë për një klasifikim Nën Standard.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet Nën Standard, të paktën nëse kriteriumet në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 60 ditëve që nga data e skadimit të kredisë .
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 60 ditë pa e paguar këtë tejkalim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të paguar këstet e kredisë sipas kontratës (duke përfshirë edhe interesin) për më tepër se 60 ditë.
- (d) Nëse afati i kthimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 60 ditë për arsye të mospagimit.

Të dyshimta. Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, përmbajnë të gjitha dobësitë të cilat janë të qenësishme në kreditë Nën Standarde, por të cilat theksojnë që ekzistojnë mundësitë e forta që pjesa e

rëndësishme e shumës së këstit nuk do të paguhet. Ka mundësi të humbjes, mirëpo shuma e saktë nuk mund të definohet saktësisht në rastin e shqyrtimit apo kjo varet edhe nga shfaqja e ndonjë veprimi apo rasti në të ardhmen. Ndonëse mundësia e humbjes është jashtëzakonisht e lartë, për shkak të faktorëve të rëndësishëm dhe të pazgjidhur specifik, por të cilët mund të funksionojnë për të mirën dhe përforcimin e kredisë, klasifikimi i saj si humbje e përafërt mund të shtyhet deri sa të përcaktohet një status më i saktë. Shembuj të faktorëve të tillë përfshihen por nuk janë të limituar në bashkimin, përvetësimin, ristrukturimin e kapitalit, si dhe furnizimin me kolaterale të reja apo plane të reja të rifinancimit. Garantuesve që nuk bashkëpunojnë apo atyre që janë në një gjendje të dobët financiare nuk duhet të konsiderohen si të aftë për të mbështetur kredinë. Mbështetje në çfarëdo kolaterali të disponueshëm që nuk do të ishte i mjaftueshëm për të mbuluar shumën gjithashtu mund të arsyetojnë klasifikimin e dyshimtë.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet si i dyshimtë, të paktën nëse kriteriumet në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 90 ditëve që nga data e skadimit .
- (b) Nëse klienti e ka tejkalluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 90 ditë pa e paguar këtë tejkallim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkallon 90 ditë.
- (d) Nëse ka mungesë në gjendjen financiare të klientit që ka shkaktuar kapital negativ.
- (e) Nëse afati i kthimit/përfundimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 90 ditë për arsye të mospagimit.

Kreditë e këqija (humbje) janë ato ekspozimet të cilat të bazuara mbi një analizë të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, kanë vlerë të vogël ose do të kërkojnë një periudhë shtesë për të realizuar ndnjë vlerë dhe nuk janë më të arsyeshme që të mbahen në librat aktive të bankës.

Një ekspozim mund të konsiderohet si i ekspozim i keq (humbje) nëse ndonjë nga kriteret në vijim aplikohet:

- (a) Nëse depozitat/rrjedha e parasë në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e mbitërheqjes të papaguar brenda 180 ditëve nga data e skadimit të mbi tërheqjes.

- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar të kredisë mbi 5% apo më shumë për mbi 180 ditë pa e paguar këtë mbitërheqje apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkalon 180 ditë.
- (f) (d) Nëse afati i kthimit/data e skadimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 180 ditë për arsye të mospagimit.

4. Identifikimi i kolateralit

Sigurimi i kolateralit duhet të merret në konsiderim në procesin e klasifikimit. Tregu i rregullt dhe vlerat e likuidimit të kolateralit duhet të dokumentohen me anë të vlerësimit momental të bërë nga ana e palës kompetente. Aftësia e bankës për të përvetësuar dhe likuiduar kolateralin brenda një periudhe të arsyeshme duhet gjithashtu të merret në konsiderim.

Klasifikimi i shumave duhet të jetë gjithmonë shuma neto të vlerës së *pranueshme* të kolateralit. Një kolateral i pranueshëm definohet si:

- (a) kolateral në para të gatshme apo bilancet e mbledhura në llogaritë depozituese në posedim të bankës dhe që janë subjekt i një marrëveshjeje të vlefshme të kolateralit të lënë peng.
- (b) Çdo depozitë tepërcë në para të gatshme e lënë në bankë për të siguruar letrën e kredisë apo garancionin.
- (c) Letrat me vlerë apo të garantuara nga vendet e OECD (Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik) apo bankat e tyre qendrore deri në atë nivel që vlera e tregut të këtyre letrave është së paku 125% e ekspozimit, kanë siguruar se ekspozime të tilla ndodhen në pronësinë e bankës dhe janë subjekt i marrëveshjes së kolateralit të vlefshëm lënë peng, si dhe janë rivlerësuar në baza të rregullta.
- (d) Letra tjera me vlerë të tregtueshme (aksione apo bonde (detyrime) që janë të listuar dhe të tregtueshme dhe që janë të plasura në mënyrë aktive për një shkëmbim të organizuar për të cilin çmimet e tregut mund të sigurohen lehtë), vlera e tregut e të cilave është më së paku 150% e ekspozimit; sigurimet e tilla janë në pronësi të bankës, janë subjekt i një marrëveshjeje të kolateralit të vlefshëm të lënë peng, si dhe janë rivlerësuar në baza të rregullta.

- (e) Një garancion i pakushtëzuar nga një bankë tjetër që është i klasifikuar BBB apo më mirë nga ana e një agjensioni të njohur ndërkombëtar dhe që ka reputacion të klasifikimit kreditor.

Si rregull e përgjithshme, llojet e tjera të kolateralit nuk duhet të zbriten nga shuma e ekspozimit për arsye të klasifikimit. Megjithatë, kolaterali, gjendja e tij, arritja dhe vlera, që është e aplikueshme, mund të jenë faktorë në përcaktimin e ashpërsisë së klasifikimit të ekspozimit.

5. Shlyerjet

Bankat duhet të zhvillojnë politika, të cilat përshkruajnë bazat mbi të cilat ekspozimet kreditore të pambledhura janë të njohura si humbje dhe të shlyera. Kur një kredi të klasifikohet si “ Humbje”, atëherë vetë banka detyrohet që të ndajë provizionin për humbje nga huatë dhe duhet që të shlyejë nga bilanci i gjendjes, pasi që janë ndërmarrë masa të arsyeshme të mbledhjes së kredisë në pajtim me politikat e përpiluara të bankës.

6. Vendimet e AQBK-së

Klasifikimet e brendshme të ekspozimeve kreditore të bankave duhet të jenë subjekt i shqyrtimit si dhe ri-klasifikimit të mundshëm nga AQBK-ja gjatë ekzaminimeve rutinore. Diferencat në mes të klasifikimit të AQBK-së dhe të klasifikimit të bankës duhet të diskutohen gjatë ekzaminimit në vend; pas këtyre diskutimeve, vendimi klasifikues i AQBK-së do të jetë përfundimtar për të gjitha qëllimet.

Paragrafi paraprijës nuk e parandalon bankën që të ri-klasifikojë ekspozimet kreditore gjatë periudhave në mes të ekzaminimeve. AQBK-ja e kupton që faktorët kreditorë mund të ndryshojnë gjatë kohës. Në të vërtetë, AQBK-ja pret që bankat duhet të ndërmarrin hapa që të përmirësojnë aftësinë kreditore të ekspozimeve të klasifikuara. Ngjajshëm me këtë, po ashtu është e mundshme që kushtet financiare të huamarrësit mund të keqësohen në mes ekzaminimeve. Në këto raste kur ndryshimet në faktorët kreditorë, qoftë pozitiv apo negativ, në mënyrë signifikante e ndryshojnë bazën në bazë të së cilës një ekspozim është klasifikuar, AQBK-ja pret që banka në mënyrë adekuate do të ndryshojë klasifikimin dhe provizionin përkatës.

7. Trajtimi i kredive të shumëfishta të një huamarrësi të vetëm apo grupi të huamarrësve të ndërlidhur

Çdo zgjatje e veqantë e kredisë ndaj një huamarrësi apo grupi duhet të vlerësohet dhe të klasifikohet duke u bazuar në meritat dhe faktorët që janë të lidhur me paradhënien apo vetë ekspozimin e caktuar. Megjithatë, problemet me një paradhënie shpesh janë tregues se problemet mund të shtrihen në tërë marrëdhënien kreditore. Kështu që, AQBK-ja rekomandon që ekspozimet që përfshijnë kredi të shumëfishta ndaj një huamarrësi të vetëm ose grupi të huamarrësve të ndërlidhur të rishqyrtohen në tërësinë e tyre si dhe individualisht, për të përcaktuar efektin e marrëdhënies reciproke të secilës kredi; nëse

dobësitë e kredive janë të veçuara ndaj ekspozimeve individuale, ose nëse ndikojnë në kreditë e tjera . Kërkesë e pandashme e këtij rekomandimi është se bankat duhet të kenë njohuri të plotë në lidhje me marrëdhëniet e bizneseve të kredimarrësve të tyre dhe të kenë sisteme adekuate informative të menaxhmentit me anë të të cilave monitorojnë totalin e ekspozimeve.

AQBK-ja pret që bankat të dokumentojnë në tërësi dhe të analizojnë të gjitha marrëdhëniet brenda portfolios së tyre dhe të abstenojnë nga huadhëniet “nominee” për të t’ju shmangur limitit të huadhënjes të imponuar nga rregulloret dhe rregullat e tjera të AQBK-së, apo për të fshehur përfitimet themelore të të ardhurave. Dështimi për t’i dokumentuar saktësisht marrëdhëniet do të konsiderohet si praktikë jo e shëndoshë bankare. Aksionarët bankar, drejtorët dhe zyrtarët, të cilët me vetëdije i mbajnë të fshehura marrëdhëniet e tilla, do t’i nënshtrohen masave ndëshkuese të AQBK-së, duke përfshirë këtu edhe detyrimin për të kompensuar çfarëdo humbje që banka ka pësuar nga ekspozimet e këtilla kreditore.

8. Klasifikimet e “ndara”

AQBK-ja e kupton se faktorët që rrethojnë një kredi të caktuar (vlera dhe likuiditeti i sigurisë së kolateralit, garantuesit e pjesëshëm, burime të ndryshme të ri-pagesës, etj) mund të sjellin situata ku një pjesë e kredisë është mjaftë e mbrojtur ose më mirë e mbrojtur se sa disa pjesë të tjera. Në situata të tilla, ku faktorët kreditor dokumentohen dhe sigurohen, bankave u lejohet që të ndajnë klasifikimet dhe provizionet e kërkuara përkatëse në mënyrë që të përshkruajnë më saktësisht rrezikun aktual kreditor.

9. Klasifikimi i angazhimeve jashtë bilancore dhe obligimeve të mundshme

Shqyrtimi i ekspozimeve të huamarrësve individual duhet të përfshijë angazhimet jashtë bilancore dhe detyrimet e mundshme të bankës, të cilat po ashtu përfaqësojnë edhe një ekspozim të huamarrësit. Kjo përfshinë:

- 1) Pjesët e pashfrytëzuara të linjave kreditore të aprovuara/të pakthyeshme. Këto zakonisht do të klasifikohen në kategorinë e njëjtë me shumën e tërhequr sipas këtyre linjave. Aty ku detyrimet e pakthyeshme nuk janë në përdorim (nuk janë të tërhequra), klasifikimi duhet të bazohet në bazë të shqyrtimit të faktorëve të tjerë kreditor dhe të dhënave financiare të përshkruara më herët në këtë rregull.
- 2) Zëvendësime kreditore si garancionet, letrat kreditore në pritje, dhe letrat komerciale të kredive. Këto duhet të klasifikohen duke përdorur standardet e njëjta që janë përdorur për të gjykuar aftësinë kreditore të suksesit të bilancit të gjendjes. Mungesa e ndonjë të dhënë të dokumentuar apo evidence do të ndikoj që këto ekspozime të klasifikohen në të njëjtën kategori sikurse ekspozimet e tjera ndaj klientëve të bankës.

Klasifikimet duhet të bëhen për shumat që janë neto të vlerës së vlerësuar momentale të kolateralit të pranueshëm.

10. Klasifikimi i letrave investuese me vlerë

Aksionet (kapitali) dhe detyrimet (letrat me vlerë) duhet të klasifikohen duke u bazuar në aftësinë kreditore të lëshuesit të letrave me vlerë, aty ku është e përshatshme, garantuesi apo nxitësit kreditor. Aftësia kreditore duhet të përcaktohet me anë të analizave të informatave momentale financiare dhe / apo referencave të klasifikimit të letrave me vlerë të siguruara nga ndonjë agjenci e njohur e klasifikimit kreditor. AQBK-ja i konsideron klasifikimet më të vogla se BBB (apo ekuivalente) për të qenë spekulative dhe subjekt klasifikimi. Nëse banka nuk ka në dispozicion klasifikimin e këtillë, si dhe nuk ka informacione momentale financiare, investimi duhet të klasifikohet si “humbje” dhe të provizionet plotësisht.

11. Klasifikimi i ekspozimeve të bankave korespondente

Ekspozimet ndaj bankave të huaja, depozitave si dhe transaksioneve huadhënëse të ngjashme (si treg i shkëmbimeve të huaja dhe aktiviteteve të prejardhura) duhet të jenë vetëm me ato banka të klasifikuara nën A apo më lartë nga një agjencion i njohur i klasifikimit ndërkombëtar të bankave. Ekspozimet ndaj bankave vendore nuk duhet t'i nënshtrohen kërkesave të tilla. Të gjitha ekspozimet duhet të mbështeten me informacione të duhura financiare si dhe informacione tjera kreditore. Klasifikimi duhet të bazohet mbi faktor të njohur që përdoren për analiza bankare. Si shtesë, ekspozimet jashtë kufijëve duhet të vlerësohen në bazë të rrezikut vendor dhe rrezikut të transferit. Në rast të mos pagimit të interesit apo pagesës së kryegjësë, mungesës së çfarëdo informacioni tjetër, periudha të njëjta të performansës duhet të aplikohen si në rastin e ekspozimeve të tjera kreditore.

12. Klasifikimi i mjeteve për të cilat bankat kanë marrë titullin /pronësinë

Herë pas here, një bankë mund të marr apo të përvetësoj titullin e mjeteve të cilat do t'i përdorë për t'i shlyer borxhet. Mjetet duhet të regjistrohen në shumën neto të borxhit aktiv. Banka duhet t'i sistemoj këto mjete sa më parë që të jetë e mundshme, por në asnjë rast banka nuk guxon t'i mbaj këto mjete më shumë se pesë vite në rastet e pasurisë të patundshme ose një vit në rastet e pasurisë së luajtshme. Bankat duhet të bëjnë një vlerësim të tregut real në momentin kur pasuria të përvetësohet , dhe të caktojnë provizionin në bazë të cdo vlere të vlerësuar, shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe çmimeve të përfaqësuara të përfshira në shitjen e mjeteve relative me vlerën e regjistruar. Mjetet e këtilla, sipas natyrës së tyre, duhet të klasifikohen jo më mirë se Nën standard, dhe ndoshta edhe më keq gjersa koha e përvetësimit pa ndonjë mundësi të shitjes sipas vlerës së vlerësueshme që mund të zgjatet.

13. Klasifikimi i Mjeteve tjera

Llogaritë e brendshme, llogaritë e përkohshme apo të mbetura, mbitërheqjet e rastit, dhe llogaritë e bankave korresponduese duhet të barazohen dhe të shlyhen në baza të rregullta. AQBK-ja pret nga bankat që të shlyejnë mjetet të cilat nuk pastrohen menjëherë pasi që mos-mbledhja e tyre të bëhet e njohur. Në çdo rast, të gjitha mjetet e tilla duhet të shlyhen jo më vonë se sa 90 ditë që nga fillimi.

14. Kërkesat për Rezerva (provizion)

Provizionet specifike (Rezervat)

Provizionet minimale duhet të krijohen në bazë të kategorisë së klasifikimit. Bankat duhet të ndajnë provizion më të lartë se sa minimumi i rregulluar në rast se analizat a rrezikut kreditor të ndonjë ekspozimi specifik shfaqin një nevojë të tillë. Provizionet duhet të bëhen ndaj vlerës neto të ekspozimit pas zbritjes së kolateralit të pranueshëm. Minimumet rregullative janë si vijon:

Nën Standard	20%
Të dyshimta	50%
Humbje	100%

Si shtesë ndaj provizioneve minimale të mjeteve të klasifikuara si më lartë, AQBK-ja ka vendosur që mungesa e të dhënave adekuate financiare është dobësi serioze në shumë portfolio dhe kjo rezulton më shumë se sa një rrezik normal kreditor. Në këtë mënyrë, për çdo ekspozim kreditor komercial në shumë prej 500.000 Euro apo më shumë që nuk është i mbështetur me pasqyra të audituara ekzistuese financiare, një bankë duhet të ndajë provizion specifik që është barazi me 1% të bilancit ekzistues (apo shuma totale e detyrimit, në rast se është angazhim i detyrueshëm ligjor). Ky provizion duhet të aplikohet veq se nëse ekspozimi nuk klasifikohen më ashpër, në një rast të tillë një provizion i lidhur me klasifikimin e këtillë duhet të aplikohet.

Për këtë rregull, termi “ekzistues” nënkupton setin e pasqyrave fiskale financiare që datojnë brenda 18 muajve që nga data e shqyrtimit të qëllimit të provizionit; termi “të audituara” nënkupton setin e pasqyrave financiare për të cilat një auditor i jashtëm ka dhënë një opinion të tij.

Provizionet e përgjithshme (Rezervat)

Si shtesë ndaj provizioneve specifike të kërkuara për ekspozimet e klasifikuara, çdo bankë duhet të ndajë një provizion të përgjithshëm ndaj portfolios së mbetur, të paklasifikuar apo segmenteve të portfolios. Ky provizion mund të jetë ndaj vlerave bruto apo vlerave “neto të kolateralit të pranueshëm”, por në rastin e fundit, dokumentimi i

ekspozimeve me një kolateral të tillë duhet të mbahet në dosje për ekzaminim nga ana e mbikqyrësve të AQBK-së. Provizionet e përgjithshme duhet të ndahen në bazë të përvojave historike të dokumentuara , të rregulluara për kushte të tregut ekzistues dhe fitimprurës. Metodologjia e bankës për të përcaktuar rezervën e përgjithshme duhet të shqyrtohet dhe vlerësohet nga ana e AQBK-së gjatë ekzaminimeve të brendshme. Çdo metodogji e këtillë dhe të dhënat themelore duhet të shqyrtohen dhe të freskohen periodikisht nga ana e bankës.

15. Ri-regjistrimi i Mjeteve

Bankat duhet të kenë politikë që të drejtojnë ri-regjistrimin e mjeteve që janë shlyer më parë. AQBK-ja mendon që raste të këtilla të jenë jo të shpeshta. Gjerësisht, banka mund ta kthejë provizionin dhe të ri-regjistrojë mjetet përkatëse, vetëm atëherë kur banka në mënyrë të kënaqshme mund të dëshmojë se kualiteti i mjeteve është përmirësuar.

- (a) Për çdo ekspozim që tejkalon 5% të kapitalit të klasit të I-rë, Bordi Drejtues i bankës ose Komitetit i Menaxhimit të Riskut Kreditor duhet që të aprovojë ri-regjistrimin e mjeteve. Ky aprovim duhet të shënohet në procesverbalet e mbledhjeve të Bordit dhe duhet që të dëshmojë faktet dhe rethanat e përmirësimit që të arsyetojnë ri-regjistrimin.

Mjetet e ri-regjistruara duhet të vlerësohen nga mbikqyrësit në baza të çdo rasti dhe duhet që :

- (a) të plotësojnë kriterin për dhënien e huave të reja në pajtim me politikën e huadhënjes së bankës, *dhe*
- (b) të mos jipen kredi me kushte më të favorshme se ato që ekzistojnë për huamarrësit e ngjashëm që janë në pozita të mira kreditore me bankën; dhe
- (c) të mos i nënshtrohen klasifikimit.

Nëse kushtet e lartpërmendura nuk përmbushen, mjetet nuk do të ri-regjistrohen.

16. Trajtimi i interesit të përlllogaritur

Interesi i përlllogaritur në zërat e bilancit të gjendjes së bankës apo të institucionit mikrofinanciar (IMF) do të njihet për periudhën e caktuar gjatë kohës që interesi është fituar, pavarësisht nga koha reale e pagesës.

Kurdo që një bankë apo një IMF klasifikon një ekspozim si jo performues (të papaguar), d.m.th.. që ka delikucencë apo mospagesë në vonesë prej 90 ditësh (ekspozim i cili si rezultat i kësaj duhet të klasifikohet si Nënstandard, i dyshimtë, apo humbje), duhet të ndërpritet llogaritja e interesit të ekspozimit në bilancin e suksesit. Rregullat në vijim i përkasin trajtimi të interesit/ të ardhurave për ekspozimet jo performuese:

- a) Bankat dhe IMF-re janë të ndaluara që të përlllogarisin apo kapitalizojnë interesin e ekspozimeve kreditore të cilat janë klasifikuar si jo performuese. Interesi i arritur nga këto ekspozime mund të njihet vetëm si një e hyrë në baza të parave të gatshme – që do të thotë në momentin e pranimit. Procedura e përshkruar e kontabilitetit në çastin kur një ekspozim kategorizohet si jo performues, i bazuar në delikucencë/gjendjen e mospagimit apo kurdo që ka ndonjë dyshim në lidhje me mbledhjen e plotë të kryegjësë apo interesit, është ajo që kur interesi i përlllogaritur , por i papaguar i ekspozimit gjatë periudhës momentale të kontabilitetit duhet të kthehet jashtë të ardhurave. I gjithë interesi që është përlllogaritur por që nuk është paguar gjatë periudhës paraprake të kontabilitetit, duhet të kthehet jashtë llogarisë së fitimit të pa shpërndarë/ të mbetur. Bankat dhe IMF-të mund të llogarisin në interes të papaguar për arsye të ekspozimeve jo performuese jashtëbilacore. Nëse bankat dhe IMF-të janë duke rishqyrtuar dhe klasifikuar ekspozimet e tyre në baza të sakta, atëherë shuma të tilla normalisht nuk duhet të kalojnë periudhën tre mujore duke i paraprirë klasifikimit të kundërt (të pafavorshëm) të ekspozimit.
- b) AQBK-ja është në dijeni se disa banka dhe disa institucione mikrofinanciare nuk kanë zbatuar këtë praktikë dhe shuma substanciale mund të jenë regjistruar si të hyra apo në një llogari “të interesit të përkohshëm” në bilancin e gjendjes, që shtyen kapitalizimin e interesit të papaguar të ekspozimit të një personi. Kjo praktikë është e ndaluar nga AQBK-ja. Bankat dhe IMF-të duhet të rregullojnë librat e tyre dhe sistemet e kontabilitetit për të siguruar pajtueshmërinë. Shikoni më poshtë “Rregullimi i kamatave të përbëra”.
- c) Bankat dhe IMF-të këshillohen që, në rast se kthimi i interesit të përlllogaritur të papaguar të ekspozimeve të klasifikuara që i përket periudhës paraprake të kontabilitetit është material, AQBK-ja mund të kërkojë që të krijohen raporte për to, për aksionarët si dhe të publikohen dhe të paraqiten sërish përpara publikut. Si shtesë, pagesa e dividendës apo shpërndarjeve tjera nga të hyrat të cilat nuk janë pranuar ende dhe/apo pagesave para provizioneve të duhura janë bërë konsiderohen si praktika ilegale , praktika jo të shëndosha dhe jo të sigurta subjekt ndaj dënimeve dhe formave tjera të veprimeve të mbikëqyrjes.
- d) Bankat dhe IMF-të mund të kthejnë statusin e interesit të përlllogaritur të atyre ekspozimeve ku përlllogaritja është suspenduar vetëm pas ripagesës së plotë të borxheve të ekspozimeve.
- e) Mbikqyrësit e AQBK-së do të shqyrtojnë kontabilitetin e bankave dhe raportimin e këtyre pozicioneve gjatë ekzaminimeve në vend. Dështimi paraprak për t’u pajtuar me kërkesat e themeluara mund të konstituj në një detyrim të mundshëm dhe të rëndësishëm të bankave. Në këtë mënyrë, AQBK-ja urdhëron që shqyrtimi i portofliosë, klasifikimi dhe provizionimi të kompletohet me kohë dhe në baza të sakta.

17. Rregullimi i kamatave të përbëra

Përkufizimi. Rregullimi i kamatave të përbëra (kapitalizimi i kamatës) janë marrëveshje, mirëkuptime apo kurse të drejtimit në mes të një banke dhe një huamarrësi, në ç' rast interesi i papaguar i vonuar për arsye të kredisë së papaguar i shtohet shumës së kryegjësë të kësaj kredie me qëllim të pagesës së mëvonshme. Kjo rezulton që kamata shndërrohet në borxh mbi kamatë.

Ndalesa – përjashtimi. Asnjë bankë nuk do të mund të merret me rregullime të çfarëdoshme të kamatave të përbëra në qoftë se nuk mund të demonstrojë para AQBK-së plotësimin e këtyre kushteve:

- (a) se huamarrësi do të jetë në gjendje ta kthejë kredinë e dhënë nga qarkullimi i parave të gatshme të tij brenda një kohe të arsyeshme, *dhe*
- (b) se mundësia e kamatave të përbëra është siguruar në marrëveshjen origjinale, *dhe*
- (c) se kthimi i borxhit bazohet në ngjarje të ardhshme të mundshme e të arsyeshme që kanë gjasa të ndodhin, *dhe*
- (ç) çfarëdo kushte apo rrethana të caktuara si të përshtatshme për AQBK-në.

18. Ri-programimi i ekspozimeve të shqetësuara kreditore

Përkufizimi. Në këtë rregull termi “i shqetësuar” nënkupton çdo ekspozim që është i klasifikuar si i pafavorshëm nga AQBK-ja apo nga ana e bankës, apo cili do ekspozim i bazuar në kriterin e klasifikimit në këtë rregull, duhet të klasifikohet si i pafavorshëm.

Kërkesat

- (a) Bankat dhe IMF duhet të ri-programojnë (ristrukturojnë) ekspozimet e shqetësuara (problematike) vetëm në baza të përmirësimit të faktorëve kreditor. AQBK-ja ka vërejtur se disa banka po i ri-programojnë ekspozimet delikvente vetëm për t'i shmangur klasifikimit dhe kërkesave për provizionim. AQBK-ja konsideron se një praktikë e tillë është mashtruese dhe jo e shëndoshë. Menaxhmenti i një bankë apo një IMF duhet të dokumentojë në dosjet kreditorë për secilin person që ka një ekspozim në bankë apo IMF dhe bazat për ri-programimin e ndonjë ekspozimi kreditor dhe duhet të përgatisë një listë të ekspozimeve të ri-programuara për shqyrtim/ratifikim periodik nga ana e bordit apo komitetit kreditor. Mbikqyrësit e AQBK-së do të shqyrtojnë gjithashtu këto lista dhe dosjet përkatëse gjatë periudhës së ekzaminimit të brendshëm të secilës bankë dhe IMF për të vlerësuar praktikën dhe politikën e ri-programimit të institucionit.

- (b) Bankave dhe IMF u ndalohet kapitalizimi i kamatave delikuate në shumën e kryegjësë së çdo ekspozimi kreditor apo krijimi i ekspozimit shtesë ndaj një personi ose interesit të lidhur të atij personi në mënyrë që të paguhet kamata delikuate. Kështu që, kusht paraprak për ri-programimin e ekspozimeve problematike është që të gjitha kamatat delikuate të ripaguhen nga ana e fondit të klientit para se një kredi të ri-programohet.
- (c) Ekspozimet problematike të ri-programuara duhet të shënohen në baza të amortizimit të pagesës.
 - i) Ekspozimet kreditore të që kanë qenë ri-programuara në një kategori më të pafavorshme para ri-programimit do të vazhdojnë që të klasifikohen në të njëjtën kategori gjersa të vërehet një performanse e gjatë apo deri sa të klasifikohen nga mbikqyrësit e AQBK-së gjatë ekzaminimit të brendshëm. Performansa e gjatë është e definuar si katër pagesa të njëpasnjëshme të pagesës së kryegjësë apo/dhe interesit.
 - ii) Ekspozimet kreditore të ri-programuara që nuk rrjedhin nga ekspozimet problematike dhe/apo që nuk kanë qenë të klasifikuara në një kategori jo të favorshme para ri-programimit mund të ristrukturohen në çfarëdo baza të faktorëve të matur kreditorë . Këto do të klasifikohen në bazë të këtyre faktorëve kreditorë gjatë kohës së shqyrtimit nga ana e bankës, IMF apo mbikqyrësve të AQBK-së.Sidoqoftë, nëse ri-programimi i një ekspozimi përfshin kompromentimin e normës të interesit apo zgjatje të afatit të ri pagesës, atëherë ekspozimi i ri-programuar do të klasifikohet më ashpër.

19. Data efektive e përmirësimit

Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës e miratoj plotësimin e Rregullës së IX-të me 7 shkurt 2007. Në këtë mënyrë lëshimet e mëparshme të kësaj rregulle shfuqizohen.

Michel Svetchine
Drejtor i Përgjithshëm